

Trajnim në Belgjikë me Kolegjin e Evropës

Në datat 11-12 tetor 2023, Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) në bashkëpunim me Kolegjin e Evropës organizoi trajnimin ekzekutiv për integrimin në BE, në Bruges, Belgjikë. Pjesë e trajnimit ishin edhe nëpunës të Drejtorisë së Integritit dhe Negociatave. Trajnimi kishte si qëllim forcimin e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike në kuadër të procesit të integritit evropian dhe shërbeu edhe si një mundësi për të rritur dhe promovuar bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e përvojave dhe njohurive në fushën e integritit evropian vecanërisht në çështje që lidhen me sfidat aktuale për BE-në dhe ndikimi i këtyre sfidave në porcesin e zgjerimit, marrëdhëniet e jashtme të BE-së, financat publike dhe politikat buxhetore të BE-së, komunikimin me BE-në, si dhe me transformimin digjital të BE-së. Gjatë zhvillimit të këtij trajnimi u diskutua me ish-Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë dhe Rektoren e Kolegjit të Evropës Znj. Federica Mogherini për rëndësinë e fuqizimit të kapaciteteve institucionale për procesin e integritit evropian.

